



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Financave

Raporti fiskal mujor

Janar-Nentor 2010

Dhjetor, 2010

TABELA E PËRMBAJTJES

TREGUESIT FISKALE KRYESORË PËR PERIUDHËN JANAR-NENTOR 2010	2
Analiza e të ardhurave për periudhën janar-nentor 2010.....	2
Vështrim i përgjithshëm	2
Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera.....	3
Taksimi i konsumit (indirekt)	4
Taksimi direkt	6
Taksimi i pasurisë	8
Taksat nacionale	8
Të ardhura të tjera nga pushteti vendor	8
Të ardhurat e fondeve speciale.....	9
Analiza e shpenzimeve për periudhën Janar-Nentor 2010.....	12
Vështrim i përgjithshëm	12
Shpenzimet korente	13
Shpenzimet e personelit.....	14
Shpenzimet për interesa	15
Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes	16
Shpenzimet për subvensione	16
Shpenzimet për fonde speciale	16
Shpenzimet të pushtetit lokal	17
Pagesa e papunësisë.....	18
Shpenzimet kapitale.....	18

TREGUESIT FISKALË KRYESORË PËR PERIUdhËN JANAR-NENTOR 2010

Gjatë 11-mujorit 2010 të ardhurat totale në buxhetin e konsoliduar arritën në 293.4 miliardë lekë (shih tabelen 1). Të ardhurat totale buxhetore ishin 9.5 përqind më të larta se e njëjta periudhe e një viti më parë. Në këtë periudhë, shpenzimet totale arritën në 316.5 miliardë leke (shih tabelen 1). Në linjë me politikën fiskale stabilizuese të Qeverisë, dhe në vijim të rishikimit në ulje të shpenzimeve për 2010 kundrejt buxhetit (rishikim që u finalizua me miratimin e buxhetit të ri në Korrik 2010), shpenzimet për 11-mujorin janë 4.9 përqind më të ulëta se në periudhën 11-mujore të 2009, dhe 17 miliardë më të ulëta se planifikimi sipas buxhetit të rishikuar. Ulja e shpenzimeve gjatë 2010 kundrejt një viti më parë reflektohet më shumë në shpenzimet kapitale, që janë reduktuar me rreth 35.8 përqind në bazë vjetore, ndërsa ato korente janë rritur me 7.7 përqind në bazë vjetore.

Deficiti fiskal, i llogaritur si diferenca e të ardhurave me shpenzimet gjithsej të buxhetit të konsoliduar, arriti në 23.1 miliardë për këtë periudhë të 2010, me rënie të ndjeshme kundrejt të njëjtës periudhë të 2009 (64.6 miliardë lekë ishte deficiti fiskal i 11-mujorit të një viti më parë). Për këtë periudhë, deficiti ishte planifikuar në 34.6 miliardë lekë. Deficiti është financuar në pjesën më të madhe me burime të brëndshme (kryesisht huamarrje): 265 milionë lekë janë të ardhurat nga privatizimi të destinuara për financimin e deficitit; 14.4 miliardë lekë të ardhurat nga huamarrja e brëndshme neto. Financimi i huaj neto i deficitit ka qenë në nivelin 8.4 miliardë lekë.

Nje zhvillim i rëndesishem per financat publike ne kete fund viti ishte miratimi i Aktit normativ, ne muajin dhjetor. Duke pare ecurine e te ardhurave dhe shpenzimeve ne buxhetin e konsoliduar si dhe duke ruajtur targetin e politikës fiskale ne terma te deficitit fiskal per 2010 ne 38 miliarde leke, akti normativ ri-alokoi disa shpenzime nga pjesa “korente” dhe “huadhenia neto” e buxhetit ne pjesen e shpenzimeve kapitale, ne nivelin e 5 miliarde leke. Keto fonde shtese u alokuan per Ministrine e Puneve Publike dhe Transportit ne programin “Rrjeti i Rugeve Nacionale”, per vazhdimin e financimit te disa projekteve te nisura, me financim te brëndshem.

Tabela 1. Treguesit kryesore të buxhetit të konsoliduar për periudhën Janar-Nentor

Miliardë lekë	Janar-Nentor '09	Janar-Nentor '10	Akti normativ 2010
TE ARDHURAT TOTALE	268.0	293.4	333.7
SHPENZIMET TOTALE	332.6	316.5	371.8
Nga të cilat: SHPENZIMET KORRENTE	247.7	266.6	300.1
Nga të cilat: SHPENZIMET KAPITALE	84.9	54.5	71.0
BALANCA FISKALE	-64.6	-23.1	-38.1
BALANCA PRIMARE	-32.3	+14.1	+3.8

ANALIZA E TË ARDHURAVE PËR PERIUdhËN JANAR - NENTOR 2010

Vështrim i përgjithshëm


Të ardhurat e buxhetit të konsoliduar për periudhën 11-mujore arritën në 293.5 miliardë lekë, duke realizuar planin në masën 98.2 përqind dhe duke tejkaluar të ardhurat e një viti më parë me rreth 9.5 përqind. Të ardhurat nga tatimet dhe doganat u realizuan në masën 97.2 përqind ndaj

parashikimit, ose rreth 201.5 miliardë lekë nga 207.3 miliardë lekë të planifikuara, me rritje vjetore 6.2 përqind; të ardhurat nga pushteti vendor arritën në 10.6 miliardë lekë nga 13.5 miliardë lekë të planifikuara në buxhetin e rishikuar dhe nga 11.1 miliardë lekë të një viti më parë; të ardhurat në fondet speciale arritën 49.2 miliardë lekë nga rreth 49.1 miliardë lekë të planifikuara, dhe kundrejt 45.1 miliardë të një viti më parë, me rritje vjetore 9.1 përqind; te ardhurat nga ndihmat rezultojnë për periudhën 2.8 miliardë lekë nga rreth 2.5 miliardë lekë të një viti më parë; të ardhurat jo-tatimore kanë qenë për këtë periudhë 29.4 miliardë lekë nga 19.6 miliardë të një viti më parë, me rritje vjetore 50.2 përqind.

Sipas agjencive të mbledhjes, për nga të ardhurat e realizuara kundrejt një viti më parë administrata doganore paraqitet me mirë për periudhën, me 106.8 miliardë leke të mbledhura, 2.9 përqind më pak se parashikimi por me rritje 12.2 përqind kundrejt 11-mujorit të 2009. Sipas zerave të të ardhurave që mbledhin doganat, bie në sy performanca e rentes minerare në eksport, që është rritur me rreth 2.6 here, kryesisht si pasojë e rritjes së eksporteve të burimeve natyrore si dhe ndryshimeve në normën e taksimit dhe në strukturën e taksës gjatë gjysmës së parë të vitit 2010. Edhe të ardhurat nga akciza në dogane kanë rritje vjetore të ndjeshme me 21 përqind, në vijim edhe të ndryshimeve në listën e mallrave me akcize në mesin e këtij viti. Ndërsa të ardhurat nga TVSH në import janë 9.7 përqind më të larta se një vit më parë, ndikuar nga rigjallërimi i importeve gjatë këtij viti (rritja e importeve për 11 mujorin është 10.8 përqind, në vlerë) dhe pjesërisht nga efekti i rritjes së akcizës për disa mallra.

Administrata tatimore ka hasur me shumë vështirësi në mbledhjen e të ardhurave gjatë këtij viti, dhe ka mbledhur për periudhën të njëjtin nivel të ardhurash me një vit më parë, dhe 2.6 përqind më pak se parashikimi. Tatimet kanë patur një ulje të ndjeshme kundrejt 2009 të të ardhurave nga TVSH, me 11.2 përqind, që reflekton rritjen e ndjeshme të kontributit të eksporteve në shitjet totale të bizneseve që paguajnë TVSH krahasuar me strukturën historike (eksportet kanë TVSH zero).

Figura 1. Të ardhurat në buxhetin e konsoliduar janar-nentor



Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera

Taksimi i konsumit (indirekt)

Tatimi mbi vleren e shtuar


Nga TVSH jane mbledhur gjithsej per 11-mujorin 103.2 miliardë leke, ose 3.4 perqind me shume se nje vit me pare. Te ardhurat e mbledhura jane 6.1 perqind me pak se parashikimi ne buxhetin e rishikuar.

Nga Administrata Doganore janë mbledhur 76.3 miliardë lekë TVSH mbi importin, duke realizuar planin e periudhës ne masen 97.6 perqind. Të ardhurat nga TVSH-ja në doganë përbëjnë rreth 74 përqind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ato rezultojnë te jene 6.8 miliardë lekë më shumë ose 9.7 përqind. Të ardhurat nga TVSH në doganë ndikohen direkt nga vlera e importeve (volumet e importuara dhe çmimet në import) si dhe kursi i këmbimit të lekut me monedhat kryesore të tregtisë ndërkombëtare të Shqipërisë, Euro-s dhe Dollar-it. Sipas të dhënave të INSTAT për tregtinë e jashtme¹, importet në vlerë janë rritur me 10.8 përqind kundrejt një viti më parë, të ndikuara edhe nga rritja e çmimeve në import për mallrat kryesore dhe nga efekti i kursit të këmbimit (mesatarisht leku është zhvlerësuar me 5 përqind kundrejt një viti më parë ndaj Euro-s dhe 9 përqind ndaj Dollar-it). Kontributin me te lartë për rritjen e importeve për 10-mujorin e kanë patur këta artikuj: minerale, lëndë djegëse; ushqime, pije, duhan; tekstile dhe këpucë, materiale ndërtimi dhe metale. Në ulje vazhdojnë të jenë gjatë këtij viti importet e makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi, me 5.8 përqind më pak se gjatë 2009.

Nga administrata tatimore për periudhën Janar - Nentor janë mbledhur 27 miliardë lekë nga 31.8 miliardë lekë të planifikuara, që do të thotë 15.2 përqind më pak. Të ardhurat nga TVSH-ja në tatime përbëjnë rreth 26 përqind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2009, të ardhurat nga TVSH-ja në tatime janë ulur me 3.4 miliardë lekë, ose 11.2 përqind. Sic e thame me lart, ne totalin e TVSH ne tatime ka ndikuar kontributi i ndjeshem i eksporteve (krahasuar me nje vit me pare) ne totalin e PBB se krijuar gjate ketij viti. Kjo ka cuar dhe ne rritje te shumave te rimbursuara nga ky tatim. Gjate 11-mujorit 2010 eksportet kane shenuar rritje vjetore 59.3 perqind. Rimbursimi i TVSH-se per periudhen 11-mujore ka arritur shifren 7.4 miliardë leke nga 2.7 miliardë qe ishte nje vit me pare. Për periudhën 10-mujore, subjektet tatimpagues të TVSH janë në total 20,366 (xhiro vjetore mbi 5 milionë lekë), nga rreth 18,000 qe ishin aktive ne 2009. Tregtia dhe shërbimi përbëjnë sektorët dominues, me 67 përqind të të gjithë subjekteve me TVSH. Në grafikun më poshte paraqiten të ardhurat nga TVSH-ja për 11-mujorin në vite

Figura 2. Te ardhurat nga Tatimi mbi Vleren e Shtuar janar-nentor

¹ Te dhenat me te fundit per tregtine e jashtme I referohen 10-mujorit 2010.



Taksa doganore

Të ardhurat nga taksa doganore për periudhën Janar - Nentor janë rreth 6.4 miliardë lekë, 6 përqind me pak se parashikimi; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2009, të ardhurat nga kjo taksë janë ulur me 662 milionë lekë, ose 9.3 përqind. Niveli mesatar i taksës doganore për këtë periudhë është 1.79 përqind. Lidhur me tarifat preferenciale, gjatë këtij viti po zbatohen reduktimet që rrjedhin nga marrëveshjet e tregtisë së lirë me vendet e rajonit (CEFTA), me Turqinë dhe me vendet e Bashkimit Europian.

Akciza

Të ardhurat gjithsej nga Akciza për periudhën Janar - Nentor arritën në rreth 34.8 miliardë lekë duke shënuar rritje të konsiderueshme prej 14.1 përqind në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ose 4.3 miliardë lekë më shumë. Lidhur me ndryshimet ligjore që kanë përfshirë akcizën, në shtator të vitit 2009 u rrit akciza e kafes (e papjekur nga 50 lekë në 70 dhe e pjekur nga 100 në 140 lekë për kg) dhe akciza e cigares (nga 40 lekë për pakete në 50 lekë); ndërsa në qershor të vitit 2010 ndryshimet ishin akoma më të ndjeshme: u ul akciza mbi kafen e papjekur (nga 70 lekë në 30 lekë për kg), u hoqën nga lista e mallrave me akcizë lëngjet e frutave dhe pijet freskuese, në grupin e nënprodukteve të naftës shtohet artikulli "naftë virgin" me nivel akcize 50 lekë për litër, shtohen në listën e mallrave me akcizë: fishekzjarret, gomrat, pilat dhe bateritë primare, ambalazhet; ndryshon taksimi i llampave inkandeshente nga ad valorem në shumë fikse. Ndryshimet më thelbësore për nga impakti mbi të ardhurat kanë një kohë të shkurtër aplikimi (që nga korriku i vitit në vijim) dhe analiza e efektit neto të tyre është e vështirë. Megjithatë, për më shumë qartësi, në vijim janë pasqyruar të ardhurat sipas artikujve dhe sipas agjencive të mbledhjes.

Nga administrata doganore janë mbledhur rreth 22.1 miliardë lekë, që përbëjnë 61 përqind të të ardhurave gjithsej nga akciza. Doganat mbledhin akcizën e karburantit të importuar dhe të birres së importuar, si dhe të mallrave të tjerë që nuk taksohen me anë të pullës së akcizës (sic janë mallrat që i janë shtuar listës). Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2009, të ardhurat nga akciza në doganë janë 3.8 miliardë lekë më shumë, ose rreth 21 përqind. Sipas llojit të mallrave kryesore me akcizë, situata për periudhën ka qënë si vijon: sasia e karburanteve të zhdoganuara për periudhën Janar - Nentor 2010 është 435.6 mije ton, me rritje 10.5 përqind (19.5 miliardë lekë të ardhura ose rreth 89 përqind të të ardhurave gjithsej nga akciza që mbledh dogana); sasia e cigareve të zhdoganuara për periudhën Janar - Nentor 2010 është 3,988 ton, me rritje vjetore prej 2 përqind; muajt e fundit është rritur sasia e cigareve të zhdoganuara krahasuar me


muajt e fundit te vitit te kaluar, si reagim i kompanive ndaj anuncimit dhe miratimit te politikese se rritjes se akcizes se cigareve, qe pritet te hyje ne fuqi ne janar-shkurt te vitit 2011; sasia e birrës së zhdoganuar për periudhën Janar - Nentor 2010 është 31.7 milionë litra, me një rënie prej 6 përqind, e ndikuar nga rritja e prodhimit vendas te ketij artikulli; kafeja e zhdoganuar për periudhën ka qënë 11 përqind më pak. Të ardhurat e mbledhura nga kafeja dhe te tjera (duke përfshirë këtu mallrat e reja të listës) ka patur një rritje të ndjeshme prej 82 përqind duke arritur nivelin 2.2 miliardë lekë.

Nga administrata tatimore janë mbledhur nga akciza rreth 12.7 miliardë lekë, me rritje vjetore 4.1 përqind. Të ardhurat nga akciza të mbledhura nga tatimet përbëjnë rreth 39 përqind të të ardhurave gjithsej nga akciza. Tatimet mbledhin akcizën mbi cigaret dhe pijet alkoolike përveç birrës, përmes pullës së akcizës, si dhe akcizën e karburantit të prodhuar në vënd (ARMO). Sipas grup mallrave, të ardhurat nga karburantet e prodhuara në vënd kanë pësuar një ulje prej rreth 50 përqind si pasoje e ngadalesimit te aktivitetit te ARMO gjate ketij viti; të ardhurat e mbledhura nga cigaret, përmes pullave fiskale, janë rritur me 14.3 përqind, si pasojë e rritjes së nivelit të taksimit të cigareve në Shtator 2009 dhe sasise se importuar muajt e fundit; të ardhurat e mbledhura nga pijet alkoolike me pullë akcize kanë qëndruar pak a shumë në të njëjtin nivel me një vit më parë.

Tabela 2. Të ardhurat nga akciza sipas mallrave

Të ardhura, miliardë lekë	11 mujor 2009	11 mujor 2010	Ndryshimi %
Akciza mbi cigaret	8.6	9.9	+14.3
Akciza karburante	18.9	21.1	+11.3
Akciza pije alkoolike	1.8	1.7	-2.9
Të tjera	1.2	2.2	+82.0

Figura 3. Te ardhurat nga Akciza janar-nentor



Taksimi direkt

Tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale arritën në 24.2 miliardë lekë, duke mbetur ne te njëjtin nivel me 11-mujorin e një viti më parë.

Sipas burimit të të ardhurave, të ardhurat nga tatimi mbi pagën e të punësuarve të sektorit publik kanë qenë rreth 7.6 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej 7 përqind; të ardhurat nga tatimi mbi pagën në sektorin jo-publik kanë qenë 7.3 miliardë lekë me rritje vjetore prej 12.2 përqind, cka tregon rritje të indikatorit “*wage bill*”, që ndikohet nga niveli i punësimit dhe niveli i pagave, dmth ecuria në rritje të aktivitetit ekonomik në vend; të ardhurat nga interesat për periudhën janë në nivelin 2.9 miliardë lekë, pak a shumë në të njëjtin nivel me një vit më parë.

Tabela 3. Të ardhurat nga taksimi individual sipas burimit të të ardhurave


Të ardhura, miliardë lekë	11 mujor 2009	11 mujor 2010	Ndryshimi %
Paga sektori publik	7.1	7.6	+7.0
Paga sektori jo publik	6.5	7.3	+12.2
Interesa	2.82	2.85	+0.9
Dividendë	0.8	1.3	+56.7
Shitje pasuri e paluajtshme	2.0	2.2	+10.1
Të tjera	4.9	2.9	-40.2

Në uljen e nivelit të të ardhurave të mbledhura nga tatimi mbi të ardhurat personale krahasuar me vitin 2009 ka ndikuar zëri i të ardhurave të mbledhura mbi çmimin e shitjes në privatizimet e kompanive shtetërore (në masën 10 përqind). Gjatë vitit 2009 të ardhurat nga privatizimi për periudhën 11-mujore ishin rreth 1.8 miliardë lekë, kundrejt zero lekë të këtij viti.

Tatimi mbi të ardhurat nga biznesi

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për 11-mujorin 2010 arritën në rreth 15.9 miliardë lekë nga 15.8 miliardë të mbledhura një vit më parë, me një rritje të lehtë prej 0.8 përqind. Ecuria mujore e mbledhjes së tatimit fitimit ka qenë shumë e “crregullt” gjatë këtij viti. Vecanerisht gjatë gjashtëmujorit të parë të 2010 mbledhja e të ardhurave të tatimit fitimit ka qenë ndjeshëm në nivelin e pritshëm për arsye të rishikimit në ulje të kesteve të parapagimit nga subjektet tatimpagues, si dhe të rritjes së tepricës kreditore të tatimit fitimit krahasuar me një vit më parë. Mbledhja e tatimit është përmirësuar ndjeshëm gjatë muajit gusht, shtator dhe nëntor. Në grafikun më poshtë paraqiten të ardhurat nga tatim fitimit dhe tatimi mbi të ardhurat personale për 11-mujorin në vite.

Figura 4. Të ardhurat nga taksimi direkt janar-nentor



Të ardhurat nga taksa vendore mbi biznesin e vogël arritën në 2.25 miliardë lekë nga 2.35 miliardë të një viti më parë, me ulje prej 4 përqind. Nga të dhënat e DPT për numrin e tatimpaguesve subjekte të kësaj takse, për 10-mujorin kjo shifër është rreth 62 mijë tatimpagues nga 57 mijë të 2009, dmth me rritje 9 përqind.

Taksimi i pasurise

Per qellime analize, ketu perفشijme tatimin mbi ndertesat, mbi token bujqesore dhe taksen e kalimit te pasurise se paluajtshme. Eshte prej kohesh nje pjese problematike e sistemit tatimor, persa i takon te ardhurave te mbledhura kundrejt te ardhurave potenciale qe mund te mblidhen nga pasuria e paluajtshme. Administrimi dhe grumbullimi i takses mbi pasurine rezulton te jete pergjithesisht efektiv persa i perket bizneseve dhe institucioneve / organizatave dhe ndjek te njejten tendence ne arrijten e nivelit te parashikuar te te ardhurave me taksat dhe tarifate tjera te aplikueshme nga njesite vendore (tarifat e pastrimit, gjelberimit, ndriçimit). Nderkohe, eksperienca nuk eshte e njejte per kategorine "Familjare" te taksapaguesve. Ketu tendenca ne grumbullimin e kesaj takse eshte e ulet, dhe njesite e qeverisjes vendore kane mjaft probleme ne administrim dhe ne detyrimin per pagimin e takses. Per nivelin ende te larte te informalitetit, ka mjaft veshtiresi ne vleresimin e bazes se taksueshme, per arsye te mangesive ne deklarimin real te pasurive. Per 11-mujorin taksat mbi pasurine arrijne ne 1.7 miliarde leke, ose 9.5 perqind me te larta se nje vit me pare. Ne totalin e te ardhurave tatimore ne Shqiperi ky grup taksash ze vetem 0.71 perqind, kundrejt 6 perqind qe eshte mesatarja e vendeve te OSBE


Taksat nacionale

Të ardhurat nga taksat nacionale për periudhën, janë 16.8 miliardë lekë nga 14.3 miliardë lekë të parashikuara për periudhën Janar - Nentor. Duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, të ardhurat nga ky grup taksash ka pësuar një rritje prej 4.6 miliardë lekë, ose 38 përqind. Me te rendesishmet ne kete grup jane: taksa mbi transakcionin e makinave te perdorura, te ardhurat nga te cilat jane ne renie me 7.2 perqind kundrejt periudhes janar-nentor 2009; taksa e qarkullimit rrugor, me 3.8 miliardë (pak a shumë i njëjti nivel me një vit më parë); taksa e rentes minerare, qe ka nje rritje te ndjeshme te te ardhurave prej 110 perqind mbi baza vjetore dhe nga e cila janë mbledhur 3.1 miliardë lekë për periudhën; taksat mbi lojrat e fatit, edhe keto me rritje te ndjeshme te te ardhurave prej 65.2 perqind kundrejt te njejtes periudhe te nje viti me pare, me 4.7 miliardë leke të ardhura.

Të ardhura të tjera nga pushteti vendor

Të ardhurat e mbledhura nga taksat vendore për periudhën Janar - Nentor arritën në 10.6 miliardë lekë nga 13.5 miliardë lekë të planifikuara në buxhetin e rishikuar për 2010, ndërsa kundrejt 11-mujorit të parë të vitit 2009 të ardhurat janë ulur me 486 milionë lekë (rreth 4.4 përqind). Taksat e tjera vendore (pa taksën e biznesit të vogel dhe taksat mbi pasurinë për të cilat folëm më lart) kanë mbledhur rreth 6.6 miliardë lekë nga 8.8 të parashikuara, dhe 9.3 përqind më pak se vitin e kaluar. Në grafikun më poshtë paraqiten të ardhurat nga taksat vendore (gjithsej) për 11-mujorin e parë në vite.

Figura 5. Te ardhurat nga taksat vendore janar-nentor



Të ardhurat e fondeve speciale

Të ardhurat në fondet speciale për periudhën Janar - Nentor 2010 arritën në 49.2 miliardë lekë, me një rritje prej 9 përqind kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë. Ky grup të ardhurash përbën rreth 20 përqind të të ardhurave tatimore gjithsej për këtë periudhë. Nga totali i fondeve speciale, 47.3 miliardë lekë janë kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Nga sigurimet shoqërore janë mbledhur 41.4 miliardë lekë, me rritje vjetore 3.3 përqind; nga sigurimet shëndetësore janë mbledhur 5.9 miliardë lekë, 16 përqind më shumë se 11-mujori i një viti më parë. Përsa i takon bazës së taksueshme, nga të dhënat paraprake të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për periudhën 10-mujore rezultojnë se: në total ka një rritje të numrit mesatar të të punësuarve për efekt të derdhjes së kontributeve (sektor shtetëror dhe sektori privat) prej 3.2 përqind, ose rreth 12 mijë njësi, kundrejt mesatares vjetore të 2009 dhe 3.5 përqind më shumë se 10-mujori i 2009. Për sektorin privat rritja e numrit të të punësuarve (mesatare 10-mujor 2010 kundrejt mesatares 12 - mujor 2009) është 5.4 përqind ose afërsisht 12 mijë kontribues më shumë. Megjithatë, brenda kësaj shifre, *subjektet me TVSH kanë një rritje të kontribuesve prej 7 përqind* (ose 11 mijë kontribues) ndërsa subjektet e biznesit të vogël një rritje më modeste prej 2.4 përqind. Numri mesatar i kontribuesve në sektorin publik (buxhetorë dhe ndërmarrje shtetërore) rezultojnë i njëjtë me mesataren e vitit 2009.

Figura 6. Te ardhurat ne Fondet Speciale janar-nentor




Tabela 4. Të ardhurat sipas klasifikimit ekonomik


	EMERTIMI	11 Mujor 2009 mld leke	11 Mujor 2010 mld leke	%
	TE ARDHURAT NE BUXHETIN E KONSOLIDUAR	268.0	293.4	+9.5
A	Te ardhura tatimore	246.0	261.3	+6.2
I	Tatimet mbi te ardhurat	42.4	42.4	+0.1
<i>I.1</i>	<i>Tatimi mbi te ardhurat personale, nga i cili:</i>	<i>24.2</i>	<i>24.2</i>	<i>+0.0</i>
	Tatimi mbi pagen ne sektorin publik	7.1	7.6	+7.0
	Tatimi mbi pagen ne sektorin jopublik	6.5	7.3	12.2
	Tatimi mbi te ardhurat nga interesat	2.8	2.9	+0.9
	Tatimi mbi te ardhurat nga dividendet	0.8	1.3	+56.7
	Tatimi mbi te ardhurat nga shitja e pasurise	2.0	2.2	+10.1
	Te tjera	5.0	3.0	-40.2
<i>I.2</i>	<i>Tatimi mbi te ardhurat nga biznesi</i>	<i>18.1</i>	<i>18.2</i>	<i>+0.2</i>
	Tatim fitimi	15.8	15.9	+0.8
	Taksa mbi biznesin e vogel	2.35	2.25	-4.0
II	Te ardhurat ne fondet speciale	45.1	49.2	+9.1
III	Taksimi i pasurise	1.6	1.7	+9.5
	Tatimi mbi ndertesat	0.1	1.2	+9.9
	Tatimi mbi token bujqesore	0.3	0.4	+7.5
	Taksa mbi kalimin e pasurise	0.19	0.21	+11.0
IV	Taksat indirekte mbi mallrat dhe sherbimet	130.4	138.1	+5.9
IV.1	Tatimet mbi shitjen	99.9	103.2	+3.4
	TVSH mbi shitjet brenda vendit	30.4	27.0	-11.2
	TVSH mbi mallrat e importuara	69.5	76.3	+9.7
IV.2	Akcizat	30.5	34.8	+14.1
	Mbi karburantet	18.9	21.1	+11.3
	Mbi alkoolin dhe nenproduktet e tij	1.8	1.7	-2.9
	Mbi duhanin dhe nenproduktet e tij	8.6	9.9	+14.3
	Te tjera (kafe, etj)	1.2	2.2	+82.0
V	Taksimi i automjeteve	4.5	4.5	+0.2
	Taksa per regjistrimin e automjeteve	0.6	0.7	+10.1
	Taksa e qarkullimit rrugor	3.9	3.8	-1.9
VI	Te tjera taksa mbi mallra dhe sherbime (nacionale)	8.3	13.0	+56.8
	Taksa mbi transakcionet e makinave te perdorura	2.6	2.4	-7.2
	Renta minerare	1.5	3.1	+110.1
	Taksat mbi kazinote dhe lojrat e fatit	2.9	4.7	+65.2
	Te tjera	1.3	2.7	+104.9
VII	Taksat mbi tregtine nderkombetare	7.1	6.4	-9.3
VIII	Te tjera taksa lokale	6.5	5.9	-9.3
B	Te ardhura jo tatimore, nga te cilat:	19.6	29.4	+50.2
	Tarifa sherbimesh	3.7	2.7	-25.5
C	Grante	2.5	2.8	+10.3

ANALIZA E SHPENZIMEVE PËR PERIUDHËN JANAR – NENTOR 2010

Vështrim i përgjithshëm

Shpenzimet e përgjithshme te buxhetit, ne fund te njembdhjetemujorit 2010, arriten ne rreth 316.5 miliarde leke, nga rreth 335.5 miliarde leke te parashikuara per kete periudhe, duke u realizuar ne rreth 94.3 perqind te parashikimit te periudhes ose me nje mosrealizim prej rreth 19.0 miliarde leke. Krahasuar me planin vjetor, keto shpenzime jane realizuar ne rreth 85.1 perqind, ndersa kundrejt te njejtës periudhe te nje viti me pare, shpenzimet buxhetore rezultojne rreth 16.1 miliarde leke me pak ose rreth 4.9 perqind me te ulta. Ecuria e shpenzimeve buxhetore ne shume absolute, si dhe ritmi i rritjes se tyre gjate njembdhjetemujoreve, ne disa vite, jepet ne grafikun e meposhtem

Figura 7. Shpenzimet e përgjithshme janar-nentor



Ne analizen e shpenzimeve **duhet mbajtur parasysh edhe fakti** se deri ne fund te njembdhjetemujorit 2010, shpenzimet e kryera nepermjet perdorimit te fondit rezerve te Keshillit te ministrave dhe kontigjences, jane reflektuar ne zerat e shpenzimeve ku ato jane kryer, si me poshte:

Fondi rezerve i Keshillit te Ministrave, prej rreth 2.4 miliarde leke, i ekzekutuar deri ne fund te nentorit 2010, eshte perdorur ne rreth 23.3 milione leke per shpenzime per paga, ne rreth 3 milione leke ne shpenzime per sigurime shoqerore, ne rreth 502.9 milione leke per subvencione, ne rreth 1,260.5 milione leke per shpenzime te tjera korente dhe ne rreth 608.9 milione leke per investime.

Fondi i kontigjences prej 2.7 miliarde leke, i ekzekutuar deri ne fund te njembdhjetemujorit 2010 eshte perdorur ne rreth 1.5 miliarde leke per shpenzime operative dhe te mirembajtjes dhe rreth 1.2 miliarde leke per subvencion.

Shpenzimet e përgjithshme sipas elementeve kryesore perberes te tyre, realizuar gjate periudhes janar-nentor 2010, jepen ne tabelen e meposhtme:


SHPENZIMET NE VITE

në milionë leke

	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
TOTALI I SHPENZIMEVE	143,780	157,660	163,152	174,224	190,156	197,108	202,325	222,254	285,867	332,651	316,508
I. Shpenzime Korrente	116,646	123,197	133,880	149,409	160,410	168,477	170,594	184,434	212,829	247,683	266,647
1 Personi	28,996	35,440	36,039	38,492	42,413	46,462	48,884	50,921	58,033	55,934	58,818
2 Interesat	27,723	21,706	22,530	27,563	26,456	24,010	23,256	22,966	28,599	32,345	37,156
3 Shpenzime Operative Mrenbajtje	15,470	13,487	17,801	19,473	20,610	20,364	17,256	19,525	22,182	26,244	29,221
4 Subvencionet	4,008	6,636	5,887	4,014	4,134	2,978	2,065	2,094	1,791	1,833	3,352
5 Shpenzime per Sg.Sociale	28,077	32,462	35,895	40,096	44,778	49,282	53,064	62,067	68,130	86,775	95,576
6 Buxheti Ideal	4,917	5,800	8,508	12,591	13,260	16,301	17,018	16,653	22,338	29,276	26,446
7 Shpenzime te tjera	7,455	7,666	7,220	7,180	8,759	9,080	9,051	10,208	11,756	14,765	16,078
II. Shpenzime Kapitale	26,386	33,011	29,272	24,815	29,746	28,631	31,731	32,820	69,136	84,883	54,532
1 Financimi Brendshem	14,513	18,660	14,063	15,232	19,939	19,374	21,454	26,170	31,819	69,396	38,641
2 Financimi Huj	11,585	14,351	15,209	9,583	9,807	9,257	10,277	6,650	37,317	15,487	15,891

Ne totalin e shpenzimeve buxhetore te realizuara, gjate njembjedhjetemujorit 2010, shpenzimet korente zene rreth 84.2 perqind, nderkohe qe shpenzimet per investime zene rreth 17.2 perqind (diferenca eshte huadhenia neto, me rreth -1.4 perqind). Nje vit me pare struktura e shpenzimeve te pergjithshme te buxhetit te shtetit te realizuara gjate periudhes janar-nentor, ishte rreth 74.5 perqind shpenzimet korente dhe rreth 25.5 perqind shpenzimet kapitale.


Figura 8. Struktura e shpenzimeve janar-nentor



Shpenzimet Korrente

Shpenzimet korente ne fund te muajit nentor 2010, kane arritur ne rreth 266.6 miliarde leke ose rreth 6.0 miliarde leke me pak se parashikimi i periudhes ose rreth 97.8 perqind e ketij parashikimi. Krahasuar me planin vjetor keto shpenzime jane realizuar ne rreth 88.4 perqind, nderkohe qe krahasuar me te njejten periudhe te vitit te kaluar, keto shpenzime rezultojne rreth 19.0 miliarde leke me te larta ose rreth 7.7 perqind me shume.

Figura 9. Shpenzimet korente janar-nentor




Sipas zerave perberes te shpenzimeve korente, situata e realizimit te tyre ne fund te muajit nentor 2010, paraqitet si ne tabelen e meposhtme:

	Shpenzimet korente	Parashikimi janar-nentor 2010 ne mln leke	Realizimi janar-nentor 2010		
			Ne mln leke	Ne %	Struktura ne %
1	Shpenzime personeli	60,866	58,818	96.6	22.2
2	Interesa	38,762	37,156	95.9	13.9
3	Shpenz oper, mirembajtjes	27,928	29,221	104.6	10.9
4	Subvensionet	1,687	3,352	198.7	1.2
5	Shpenzimet per fonde speciale	98,778	95,576	96.8	35.9
6	Shpenzimet buxh vendore	27,121	26,446	97.5	9.9
7	Shpenzime te tjera	17,496	1,6078	91.9	6.0
	Totali i shpenzimeve korente	272,637	266,648	97.8	100.0

Shpenzimet e Personelit

Brenda shpenzimeve korente, **shpenzimet e personelit**, qe perfaqesojne rreth 22.2 perqind te totalit te shpenzimeve korente te realizuara gjate periudhes janar-nentor 2010, rezultojne me nje mosrealizim prej rreth 2.0 miliarde leke ose rreth 96.6 perqind te parashikimit te periudhes. Kundrejt planit vjetor keto shpenzime ne fund te muajit nentor jane realizuar ne rreth 88.0 perqind te tij, nderkohe qe krahasuar me te njejten periudhe te nje viti me pare shpenzimet e personelit rezultojne rreth 2.8 miliarde leke me te larta, ose rreth 5.2 perqind me shume.

Figura 10. Shpenzimet per personelin janar-nentor




Shpenzimet per paga jane rreth 490 milione leke me pak se parashikimi i periudhes, duke qene ne te njejten kohe rreth 3.1 miliarde leke me te larta se nje vit me pare ose rreth 6.4 perqind me shume se nje vit me pare, nderkohe qe shpenzimet per sigurimet shoqerore jane rreth 190 milione leke me pak ose rreth 2.3 perqind me te ulta, se nje vit me pare.

Shpenzimet për Interesa

Shpenzimet per interesa qe perfaqesojne rreth 13.9 perqind te totalit te shpenzimeve korente te realizuara gjate periudhes janar-nentor 2010, rezultojne me nje kursim prej rreth 1.6 miliarde leke, rrjedhoje kjo e kursimit per rreth 536 milione leke ne interesat e brendeshme dhe rreth 1.1 miliarde leke ne interesat e jashtme. Kundrejt planit vjetor interesat jane realizuar ne rreth 85.4 perqind, ndersa krahasuar me nje vit me pare ato rezultojne rreth 4.8 miliarde leke me te larta ose rreth 14.9 perqind me shume. Ecuria e shpenzimeve per interesa gjate njembjedhete muajve te pare, ne vite jepet nga grafiku i meposhtem:


Figura 11. Shpenzimet per interesa janar-nentor



Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes

Shpenzimet operative dhe te mirembajtjes qe perfaqesojne rreth 10.9 perqind te totalit te shpenzimeve korente te realizuara gjate periudhes janar-nentor 2010, arriten ne rreth 29.2 miliarde leke ose rreth 94.8 perqind te planit vjetor. Ne te njejten kohe ato rezultojne rreth 3.0 miliarde leke ose rreth 11.3 perqind me shume se nivelet e realizimit te vitit te kaluar.


Figura 12. Shpenzimet O&M janar-nentor



Shpenzimet për Subvencione

Shpenzimet per subvencione ne fund te muajit nentor 2010 arriten ne rreth 3.4 miliarde, rrjedhoje kjo e shlyerjes se detyrimeve te prapambetura te ndermarrjeve te ujesjellesve per energjine elektrike, per te cilen ne masen 500 milione leke eshte perdorur fondi rezerve i buxhetit te shtetit dhe ne rreth 1.2 miliarde leke fondi i kontigjences.

Figura 13. Shpenzimet per subvencione janar-nentor




Shpenzimet për Fonde Speciale

Shpenzimet per fonde speciale gjate periudhes janar-nentor 2010 rezultojne rreth 3.2 miliarde leke me pak apo rreth 3.2 perqind nen nivelin e parashikimit te periudhes. Kundrejt planit vjetor shpenzimet per fondet speciale jane realizuar ne nivelin 87.8 perqind, nga te cilat sigurimet shoqerore jane realizuar ne rreth 89.7 perqind te planit vjetor, sigurimet shendetesore jane realizuar ne rreth 88.1 perqind te ketij plani dhe kompensimi i pronareve ne rreth 102.9 perqind.

Krahasuar me nje vit me pare shpenzimet per sigurimet shoqerore rezultojne rreth 5.0 miliarde leke me te larta ose rreth 7.6 perqind me shume, ndersa shpenzimet per sigurimet shendetesore rezultojne rreth 2 miliarde leke me te larta, ose rreth 9.7 perqind me shume.


Figura 14. Shpenzimet per sigurime shoq.&shend janar-nentor



Shpenzime të Pushtetit Lokal

Shpenzimet e pushtetit lokal zene rreth 9.9 perqind te shpenzimeve korente. Per periudhen janar- nentor 2010 ato kane arritur ne rreth 26.4 miliarde leke ose rreth 675 milione leke me pak se niveli i planifikuar per kete periudhe te vitit 2010. Kundrejt planit vjetor keto shpenzime kane arritur ne rreth 87.0 perqind te tij. Krahasuar me nje vit me pare keto shpenzime rezultojne rreth 2.8 miliarde leke me te ulta ose rreth 9.7 perqind me pak. Ecuria e shpenzimeve te pushtetit lokal per periudhen janar-nentor per disa vite jepet nga grafiku i meposhtem.

Figura 15. Shpenzimet per pushtetin lokal janar-nentor




Pagesa e Papunësisë

Pagesa e papunesise rezulton ne rreth 99.1 perqind e planifikimit vjetor, duke qene rreth 19.9 perqind me shume se ne te njejten periudhe te vitit te kaluar.

Ndihma ekonomike gjate periudhes janar-nentor 2010 rezulton rreth 279 milione leke me pak ose rreth 1.8 perqind nen parashikimin e periudhes, duke qene ne te njejten kohe rreth 88.8 perqind e planit vjetor.

Figura 16. Shpenzimet per mbrojtjen sociale janar-nentor




Shpenzimet Kapitale

Shpenzimet kapitale deri ne fund te muajit nentor 2010 jane realizuar ne rreth 82.6 perqind te planit vjetor. Brenda ketyre shpenzimeve, investimet me financim te brendeshem jane realizuar ne masen 92.3 perqind, nderkohe qe investimet me financim te huaj jane realizuar ne masen 75.1 perqind te parashikimit vjetor. Krahasuar me te njejten periudhe te vitit te kaluar

investimet e brendeshme rezultojne rreth 30.9 miliarde leke me te ulta ose rreth 44.3 perqind me pak, nderkohe qe investimet me financim te huaj rezultojne rreth 404 milione leke me te larta ose rreth 2.6 perqind me shume. Per rrjedhoje, investimet ne total ne fund te muajit nentor 2010 jane rreth 35.8 perqind me te ulta ose rreth 30.4 miliarde leke me pak se ne te njejten periudhe te nje viti me pare.

Figura 17. Shpenzimet kapitale janar-nentor



Struktura e investimeve kapitale te realizuar gjate periudhes janar-nentor 2010 eshte rreth 70.9 perqind nga financimi i brendshem dhe rreth 29.1 perqind nga financimi i huaj.

Ecuria e investimeve kapitale me financim te brendeshem dhe me financim te huaj gjate njembjedhetemujoreve ne disa vite jepet nga grafiku i meposhtem.

Figura 18. Financimi i investimeve publike janar-nentor

